



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:255321

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06520836

2023:255322

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL, gjyqtarja Kreshnike Zymberi Beqiri si dhe bashkëpunëtoren profesionale Ilirjana Hashani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëseve R.R. dhe S. H. që të dy me vendbanim në Komunën e .... të cilët i përfaqëson me autorizim av. Labinot Buzuku nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurës Komuna Shtimes - Drejtoria e Arsimit, në çështjen juridike kompensim i të ardhurave në emër të inflacionit dhe licencimit, vlera e kontestit 4,296.12 €, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 27 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve R. R. dhe S. H., kundër të paditurës Komuna ....- Drejtoria e Arsimit, si e bazuar.
- II. DETYROHET e paditura Komuna Shtimes - Drejtoria e Arsimit, që paditëseve:
  1. R. R. dhe atë:
    - a) në emër të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit me ngritje page 27% pagës bazë shumen mujore prej 55.35 euro nga data 01.12.2020 deri më datë 31.01.2023 për 26 muaj të ia paguaj shumën prej 1,439.10 euro;
    - b) në bazë të përqindjes së inflacionit për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.76 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 537.20 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 708.96 €
  2. S. H. dhe atë:
    - a) në emër të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit me ngritje page 27% pagës bazë shumen mujore prej 55.35 euro nga data 01.12.2020 deri më datë 31.01.2023 për 26 muaj të ia paguaj shumën prej 1,439.10 euro;
    - b) në bazë të përqindjes së inflacionit për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.76 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 537.20 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 708.96 € (shtatëqind e tetë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent)

Të gjitha këto secilit paditës veç e veç me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë 22.11.2023 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 196.00€ (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmëria së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarrimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre me date 22.11.2023 pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me të cilën kanë kërkuar kompensimin mbi bazën juridike të inflacionit dhe kompensim për licencim si dhe ka bërë precizimin e saj me të cilën ka kërkuar kompensimin për inflacion në bazë të përqindjes së inflacionit për periudhën për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 537.20 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme për secilin prej 708.96 €, si dhe për ne emer të diferencës për kualifikim -licencim shumën prej 1,439.10 euro m për secilin paditës veç e veç, e që në shumë të përgjithshme prej 10,740.30 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në afat prej 7 dite nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses është e pabazuar pasi që kontrata kolektive e nënshkruar më dt. 17.04.2017 nuk është më në fuqi ndërsa sipas ligjit të punës kërkesëpadija e paditësit është e parashkruar. Kontrata kolektive ka paraparë që shkalla e inflacionit sipas entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e saj të futet në pagë dhe kompetente për llogaritjen dhe përfshirjen e inflacionit në pagë është enti i Statistikave të Kosovës. I ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka çmuar se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 lidhur me nenin 143 të LPK-së, pasi konstatoi se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, përkundrajt kontestimit të kërkesëpadiës dhe se ka vlerësuar se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, e që në rastin konkret ka rezultuar se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditëses është qartazi e

themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në SHFMU “... ” në fshatin .... Komuna Shtime, e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë të kontratave të punës me numer 05/315 e dates 26.01.2016 ne emer te paditesit të parë, kontrata me numer 05/316 e dates 26.01.2016 ne emer te paditesit të dytë ,si dhe nuk është kontestuese se paditësit gjenden, në listën e pagave dhe kan pagën bazë 421.00 euro dhe se në emër të kualifikimit per Fakultet në pagën bazë mujore paditesve u është paguar shuma prej 52.65 euro.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigjen në padi, Gjykata ka vlerësuar se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratat Kolektive të nënshkuara nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 respektivisht me nenin 48 të këtyre kontratave është përcaktuar se këto kontrata hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me Kontratën Kolektive të datës 18.04.2017 respektivisht atë të datës 22.01.2021, në nenin 35.10 thuhet “Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ku gjykata bazuar në listat e pagës nuk rezulton se shkalla e inflacionit është futur në pagë, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me shkallën e inflacionit e ka bazuar në të dhëna zyrtare të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës përmes faqes zyrtare.

Bazuar në këto të dhëna rezulton se shkalla mesatarja vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës u ka aprovuar paditëseve kompensimin për inflacion për vitin 2019 për periudhën prill – dhjetor në përqindje 2.7% shumën ,per vitin 2020 për muajt Janar – Dhjetor në shkallën e inflacionit prej 0,2% , për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% dhe shumat si në dispozitvin II të këtij aktgjykimi, si të bazuara.

Gjykata gjeti se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të

kritereve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësesve t’ua bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës të specifikuar si me lart, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ua ka paguar shumën prej 52.65 euro . Sipas pikës 3 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve për çdo muaj t’ua paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur të vlerës për sa do të takonte kompensimi në shumë prej 113.67 euro , e që i bie se 26 muaj nga data 01.12.2020 deri më datë 31.01.2023 në shumë të përgjithshme prej 1,439.10 euro per secilin.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditëseve t’ua paguaj shumën e specifikuar në pikën II të dispozitivit .

Andaj meqenëse ashtu siç është rregulluar e paditura ka pasur detyrim të paditësit t’ia fut në pagë shkallën e inflacionit të cilën gjë nuk e ka bërë për periudhën kontestuese, në njërin anë kurse në anën tjetër edhe paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, dhe asaj të datës 22.01.2021 sa i përket mjeteve monetare në emër të shkallës së përqindjes së inflacionit dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se “Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësit. Në rastin konkret gjykata i zbatoj dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/212 ku shprehimisht thuhet “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje të tillë kolektive”.

Nga këto pretendimet gjykata ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit bazohet në Kontratën Kolektive të Arsimit e vitit 2017 respektivisht neni 7 par.1 pika 1.2 dhe nga kjo dispozitë ligjore të paditurës i ka lindur detyrimi për kompensimin e kësaj difference në pagë tek pala paditëse, për më tepër vetë pala e paditur në mënyrë të heshtur ka pranuar këtë

detyrim ndaj paditëses, në momentin që e njëjta ua ka paguar shumën prej 52.65 € për çdo muaj, në emër të kualifikimit licencë e mësimdhënësit të karrierës.

Andaj, nga të gjitha të lartcekurat dhe bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata ka vlerësuar se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në emër të diferencës së papaguar për inflacion dhe licencim dhe se e njëjta është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e të paditurit, e cila në këtë procedurë na paraqitet apo ka rolin e debitorit ndërsa paditësi atë të kreditorit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 04.12.2023 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 156.00 euro për përpilimin e padisë si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 40 euro, gjithsej shumën prej 196.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
C.nr.2023:255322, me datë 27 nëntor 2024

Gjyqtarja  
Kreshnike Zymberi Beqiri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.